



Pranimi / Dostizuar Priljena / Prodato Received / Delivery	01.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtrapa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOK	7197/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1336/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1336/2023, të datës 26.10.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit Nr.ref:547/2023 të datës 11.10.2023 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa më numër A.nr.1336/2023, e datës 26.10.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.ref:547/2023, i datës 11.10.2023, i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesja (*me tej referuar ankuesja*) me datë 26.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1336/2023, kundër Vendimit Nr.ref:547/2023, të datës 11.10.2023, të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për kthimin e parakohshëm të ankueses nga misioni diplomatik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje vetëm Këshilli*) bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.11.2023 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6699/2022, të datës 26.10.2023, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin e datës 05.09.2012 të ankueses, Ndryshimin dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit datës 21.01.2015 dhe 14.08.2017; Vendimin me Nr. ref: 116/2015 i datës 30.12.2015; Vendimit me Nr. Ref: 777/2018 i datës 10.09.2018; Vendimin me Nr. ref: 365/2020 i datës 14.07.2020; Vendimin me Nr. ref: 35/2022 i datës 28.01.2022; Vendimin me Nr Ref: 257/2023 te datës 14.07.2023; Vendimin me Nr.ref:547/2023 të datës 11.10.2023 të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesën për pushim të datës 18.01.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 15.11.2023; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 05.02.2010; Vendimin me Nr. ref: 396/2023 i datës 30.10.2023; Emailin e datës 14.11.2023 nga për dhe Emailin e datës 13.11.2023 nga për dhe Emailin e datës 10.11.2023 nga për Emailin e datës 08.11.2023 nga për dhe Emailin e datës 15.11.2023 nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Aktit të fundit të Emërimit Nr-216/2017 të datës 14.08.2017, është emëruar në pozitën e punës “ *Zyrtare e Lartë për Marrëdhënies Shumëpalëshe* “, në Departamentin për Çështje Rajonale, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, e njëjta me Vendimin Nr. Ref: 365/2020 të datës 14.07.2020 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është caktuar të shërbej në Misionin Konsullor në Cyrih/Zvicër, në gradën diplomatike Sekretar i Dytë, me mandat katër (4) vjeçar , duke filluar nga data 01.09.2020.

Me tej nga shkresat e lëndës rezultojnë se Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 11.10.2023 ka nxjerrë Vendim me Nr. ref: 547/2023, përmes të cilit ka shfuqizuar Vendimin me Nr. Ref:365/2020 të datës 14.07.2020, duke vendosur për tërheqjen/kthimin e ankueses nga misioni për nevojat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nga data 01.12.2023.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.ref:547/2023, të datës 11.10.2023, të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pretendon se ky vendim është nxjerr në mënyrë të kundërligjshme dhe për inate personale dhe tendencioze.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, ku me nenin 22 është përcaktuar se: “*Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrisë së Punëve të Jashtme*”, ndërsa, me nenin 23 të këtij ligji është përcaktuar se: “1. *Presidenti i Republikës së Kosovës urdhëron tërheqjen e një ambasadori apo shefi të misionit nga misioni diplomatik përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsye të mëposhtme: 1.1. për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme; 1.2. në bazë të kërkesës së vetë përfaqësuesit diplomatik; 1.3. për arsye të vlerësimit negativ të punës së përfaqësuesit diplomatik; 1.4. për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi; 1.5. kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pramues. 2. Tërheqja e të gjithë përfaqësuesëve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me*



urdhrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme”, kështu që, mbi këtë përcaktim ligjor Kolegji i Këshillit, konstaton se ministrja e MPJD, ka diskricion që për nevoja të punës dhe për interes të ministrisë, të vendos për tërheqjen e zyrtareve të angazhuar në mision diplomatik, (përjashtimisht ambasadoreve apo shefave të misionit) para skadimit të mandatit katër vjeçar.

Për më tepër Kolegji i Këshillit ju referua edhe Rregullores Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm gjegjësisht nenit 10 paragrafi 8 dhe 9, me të cilat norma parashihet se: “...8. Kohëzgjatja në detyrë për zyrtarët e angazhuar në shërbim jashtë vendit mund të ndryshojë sipas nevojave të shërbimit ose për shkak të rrethanave detyruese personale siç janë sëmundja ose vuajtje. 9. Ministria ka autoritetin të ndryshojë standardet e kohëzgjatjes së shërbimit varësisht nga kushtet e vendit të misionit ose nevojat e shërbimit”.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat e çështjes dhe si rrjedhojë konstaton se Vendimi me Nr.ref:547/2023 i datës 11.10.2023 i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerrë në pajtim me dispozitat materiale, sepse kthimi gjegjësisht tërheqja e ankueses nga misioni diplomatik është bërë mbi bazën e nevojës dhe interesit të institucionit, kështu që vendimi i goditur me ankesë është në pajtim edhe me dispozitat e nenit 53 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë”, anda, mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1336/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

